

Nr.regj.32185/12

**GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**,me gjyqëtar Murat Paçaradën dhe sek.juridik Naim Thaqi duke vendosur sips Aktvendimit të Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje me nr;1120/12,të dt.29.10.2012, në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurës Besa Halimi-Zagragja, për kundërvajtje nga neni 5.dhe 6.parg.1 dhe 3,si dhe nenit 9 e sanksionua me nenin 17 parg.1 pika 3. të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen,dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë Publik, me nr.04/L-050, e në bazë të nenit 73,74,195, dhe 199 si dhe nenit 10 të Ligjit mbi kundërvajtjet, me dt.**01.02.2013** merrë këtë,

**A K T V E N D I M**

**E PANDEHURA:**Besa Halimi-Zagragja e lindur me 29.04.1961 në Cërnicë,tani jetonë në"Prishtinë,rruga,"Naser Hajrizi"nr.43,e martuar,nenë e 3 femijve, e gjendjes së mesme ekonomike,Inspektore e arsimit,kshilltare komunale në Kuvendin e Komunës së Prishtinës.

**Ë s h t ë p ë r g j e g j ë s e**

Sepse si Kshillëtare komunale në Kuvendin e Komunës në Prishtinë,nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë pranë Agjencionit Kundër Korrupsionit për vitin 2011,në afatin e caktuar ligjor,edhe pse ka qenë e njohuar me kohë përë këtë obligim ligjor,është vonuar deri me datën 24.07.2012,kur edhe e ka bërë deklarimin e pasurisë.

Me veprim të këtill ka kryer kundërvajtje nga neni 5.dhe 6 paragrafi 1dhe.3 si dhe nenit 9 e sanksionuar me nenin 17parg.1 pika 3 të Ligjit për Deklarimin,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë,dhe Dhuratave të Zyrtarve të Lartë publik, andaj për këtë i shqiptohet:

**Q O R T I M**

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur,

Konform nenit 109.6 në emer të paushallit gjyqësor e pandehura është i obliguar të paguaj shumën prej 15 EURO, në afat prej 15 eurosh në arken e gjykatës.

Nga një kopje të këtij aktvendimi ti dërgohet të pandehurës dhe parashtruesit të kërkesës.

**A r s y e t i m**

Agjencioni Kundër Korrupsionit në Prishtinë,me kërkesën nr.01-2501/12 të parashtruar gjykatës me datën 18.05.2012 për inicimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurës të permendur me lartë, për kundërvajtjen e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata komunale për kundërvajtje në Prishtinë duke vepruar sipas kërkesës,e zvilloj procedurën kundërvajtse dhe të pandehurën e shpalli fajtor,i shqiptoj denimin Qortim,si dhe e obligoj që në emer të paushallit gjyqësor ta paguaj shumën prej 15 eurosh.

Parashtuesi i kërkesës Agjencioni Kunder Korrupsionit në aftain e parapar ligjor e atakoj Aktvendimin e Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë,me arsyetim së të pandehurës nuk ju ka shqiptue masa adekuate e denimit,por siq thuhet në ankesë ju ka shqiptue masa edukuese Qortim.

Gjykata e Lartë për Kundërvajtje me dt.29.10.2012,me Aktvendimin me nr:1120,date 29.10.2012 e abrogon Aktvendimin me nr.Regj:23185/12,lënden ja kthenë Gjykatës së shkallës së parë në rivendosje ku e obligon që të ndermerr disa veprime dhe të bënë vertetimin edhe të disa fakteve që parshtruesi i ankesës i thekson në ankesë.

Duke veprue sipas udhëzimeve të cekura në Aktvendimin GJL.NR.1120/2012,me dt.29.10.2012,gjyqtari thirri në cilësin e deshmitarit parshtruesin e kërkesës përfaqsesin e Agjencionit Antikorrupsion në Prishtinë Enis Sadikun.

Përfaqsesi i Agjencionit Antikorrupsion Enis Sadiku në deklaratën e tij thekson:Besa Halimi- Zagragja nga Prishtina ka qenë e obliguar që ta bejë deklaratimin e pasurisë sipas Kërkesës së Agjencionit Kunder Korrupsion,bazuar në nenin 9 të Ligjit mbi deklarimin e pasurisë,nga se e njeta për here të parë e ka pasur për obligim ta deklaroj pasurin,kuse për pjesën tjetër thekson parshtruesi i kërkesës mbetem pranë kërkesës.

2.

Gjykatësi edhe një herë shqyrtoj deklaratën e të pandehurës të dhenë para kësaj gjykate me datën 09.09.2012, e cila thekson së kur na kanë lajmruar se formularët për deklarinimin e pasurisë gjenden në VEB-faqen e Agjencionit Kunder Korrupsionit, unë nuk munda ti siguroj për shkak të disa problemeve teknike, e kur i sigurova formularët burrin nuk e kisha në shtëpi për të mi dhenë shenimet e sakta rreth pasurisë. Më psataj shtonë e pandehura për shkak se kisha obligime familjare siç ka qenë martesë e djalit, të jemë e singertë kam harrue që ta përmbushi këtë obligim. Edhe pse pas nja dy muajve unë e kam krye këtë obligim më vjenë shumë keq që e kam humbur afatin ligjor, jamë e penduar dhe e ndiej vehten përgjegjëse, thekson në deklaratën e saj e pandehura.

Gjykatësi me kujdes shqyrtoj edhe një herë deklaratën e parashtruesit të kërkesës, deklaratën e të pandehurës si dhe shkresat tjera të lëndës, dhe erdhi në përfundim se e pandehura Besa Zagragja-Halimi e ka kryer kundërvajtjen e cila i ngarkohet, dhe se duhet të përgjigjet për kundërvajtjen të cilën e ka bërë.

Me rastin e caktimit të denimit-Qortim- gjyqtari konform nenit 7 të LMK-së vlersoj rrethanat nën të cilat është krye kundërvajtja, duke i analizue rrethanat renduese dhe rethanat lehtësues.

Si rrethana lehtësuese gjyqtari mori parasysh se e pandehura e pranoj se është vonuar që ta benë deklarinimin e pasurisë pranë Agjencionit Kunder korrupsionit, për shkak se siq thot ka pasur obligim e familjare siq ka qenë martesë e djalit, pastaj ajo pendohet dhe e ndien vehten përgjegjëse pse është vonuar për ta krye një obligim të tillë.


Gjykatësi i muarr prasysh të gjitha këto andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke qenë i bindur se edhe me këtë QORTIM, do të arrihet të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit që e pandehura në të ardhmen nuk do ta kryej një kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme.

Me sa u tha më lartë u vendos sin e dispozitiv te ketij aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë Gjykatës së Apelit- Divizionit për kundërvajtje në Prishtinë në afat prej 8 ditë që nga dita e marrjes së aktvendimit e nëpërmes kësaj Gjykate.

**VENDOSI GJYKATA THEMELORE-DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË.**

Gjyqtari  
Murat Paçarada



DPK/DPK

e2

03-535/2013

20.02.2013